



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 800/9 Prot.

Tiranë, më 11.10.2024

V E N D I M

Nr. 266, datë 11.10.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 115, datë 27.05.2024, e z. A.K, i përfaqësuar¹ nga Avokat z. A.D kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”, dhe “çdo shkak tjetër”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Ndërmjet ankuesit A.K (në cilësinë e Punëmarrësit) dhe Shoqërisë “Albpetrol” sh.a, (në cilësinë e Punëdhënësit) është konkretizuar kontrata individuale e punës, në bazë të së cilës Punëmarrësi mori përsipër të ofroj punën dhe shërbimet e tij në pozicionin “Murator”, sipas librezës së lëshuar në datë 10.01.2020. Sqarojmë se, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, nuk na është vënë në dispozicion një kopje e kontratës së punës, edhe pse ankuesi ka kërkuar në mënyrë të përsëritur një kopje të saj. Ky pozicion pune nuk ka ndryshuar gjatë gjithë periudhës që ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë Albpetrol sh.a. Krahas pozicionit të punës së tij, ankuesi është angazhuar në kryerjen e proceseve të tjera teknike, të cilat nga natyra e tyre nuk i përkasin pozicionit të tij të punës, punë të cilat i janë ngarkuar nga eprori i tij. Konkretisht, në datën 21.02.2022, ankuesi së bashku me shtetasin z. B.Ç dhe z. K.K kanë marrë urdhër nga shefi i Sektorit të Zbatimit të Investimeve z. H.Ll dhe Kryeinxhinieri z. V.Xh për ndërrimin e llamarinave të çatisë së magazinës së vajit në ndërmarrjen QFMT, Patos. Punonjësit kanë qenë duke punuar në lartësi dhe nuk kanë qenë të pajisur me rrip trupi të

¹ Referuar Prokurës së Posaçme, nr. repertori 3166, nr. koleksioni 1148, datë 19.04.2024, të noteres M.D.

² “Për shkak të ankesës së paraqitur nga z. A.K drejtuar Drejtorisë së Shoqërisë Albpetrol, për ngjarjen e datës 16.01.2024”.

certifikuar dhe të markuar me CE që garantojnë në çdo rast sigurinë dhe shëndetin në punë, por kanë qenë të pajisur me rrip mesi jashtë standardeve, të pa testuar për mbajtjen e punonjësit në rast të rënies nga lartësia. Gjatë procesit të punës, për shkak të daljes së tubove nga platforma mbështetëse ankuesi ka rënë nga lartësia prej 7.7 metra, duke pësuar dëmtime të rënda të shëndetit dhe të rrezikshme për jetën.

Mbështetur në Aktin e ekspertimit teknik të kryer nga ekspert Dr. Ing. A.H, datë 14.11.2022 të depozituar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, është nxjerrë në përfundim se: “Nga tërësia efakteve, provave të ndodhura në dosjen objekt hetimi, analizave të kryera mbi rregullat e mbrojtjes në punë, rezulton se mosmarrja e masave teknike nga ana e punëdhënësit; Shoqërisë Albpetrol, ka ndikuar drejtpërdrejtë në ndodhjen e aksidentit me pasojë dëmtimin e punëmarrësit shtetasit A.K”.

Nga të gjitha rrethanat e lartpërmendura sqarojmë se ankuesi pretendon se ka qenë i diskriminuar në mënyrë të vazhdueshme nga ana e punëdhënësit, për shkaqet e cituara në vijim:

Së pari: Ankuesi ka qenë i diskriminuar, pasi punëdhënësi e ka urdhëruar që të kryej punë të cilat për nga natyra e tyre nuk janë brenda kuadrit të profesionit të tij “Murator”. Që nga dita e aksidentit e në vazhdim, ankuesi ka qenë i diskriminuar në mënyrë të vazhdueshme për shkak se nga dëmtimet e marra pësoi paaftësi në punë.

Së dyti: Ankuesi pretendon se ka qenë i diskriminuar pasi punëdhënësi nuk ka marrë masat e duhura teknike, konkretisht pajisjet mbrojtëse individuale për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve në punë.

Së treti: Sqarojmë se diskriminimi ka qenë i vazhdueshëm nga ana e punëdhënësit në lidhje me gjendjen shëndetësore të rënduar që ankuesi kishte, si pasojë e aksidentit në ndodhur në ambientin e punës. Në këto kushte, është e dukshme se ankuesi është diskriminuar për shkak të gjendjes të tij shëndetësore.

Në rastin objekt diskutimi, ndodhemi para faktit se ankuesi ka qenë i diskriminuar për shkak se pas aksidentit në punë ka patur dëmtime të konsiderueshme të cilat në momentin e ndodhjes kanë qenë të rrezikshme për jetën e tij dhe në këto kushte, ankuesi ka pësuar paaftësi në punë.

Ju vëmë në dijeni se diskriminimi ka vazhduar edhe pas kalimit të një kohe relativisht të gjatë, që nga momenti i ndodhjes së aksidentit, konkretisht me faktin e ndodhur në datën 16.01.2024, në ambientet e punës ankuesi ka patur një konflikt me Përgjegjësin e sektorit të Zbatim Investimeve dhe Mjedisit, z. R.B. Shkaku kryesor i nisjes së këtij konflikti ka qenë në momentin kur ankuesi do të nënshkruante në krah të emrit të tij, listën e “Instruktimit të punonjësve për sigurimin teknik dhe njohja me rreziqet e vlerësimit të riskut në punë”. Në këtë moment ankuesi vëren që krah as emrit të tij, te kategoria “Profesioni që Instruktohet” ishte vendosur titulli “Murator-Karpentier”, kur ndërkohë ankuesi ushtron pozicionin e muratorit.

Në këto kushte, duke qenë se titulli i vendosur në aktin e lartpërmendur nuk lidhet me titullin e profesionit që ankuesi realisht ka, ankuesi zhgaravit vetëm pjesën që ndodhej tek emri i tij (fjalën Karpentier) pa cenuar asnjë prej emrave të punonjësve të tjerë, por në asnjë moment nuk e gris aktin. Gjendja agravohet dhe arrin në konflikt fizik, konflikt i ushtruar nga ana e përgjegjës të sektorit kundrejt ankuesit. Në konflikt e sipër, përgjegjësi i sektorit i komunikoi ankuesit se për ditën që ndodhi konflikti dhe për ditët në vijim do t'i hiqet e drejta e pagës. Theksojmë se përgjegjësi i sektorit nuk i komunikoi në asnjë moment ankuesit se cili ka qenë shkak ligjor për marrjen e kësaj mase disiplinore, e cila iu komunikua në mënyrë verbale.

Ankuesi ka përpiluar një ankesë drejtuar Drejtorisë së Shoqërisë Albpetrol, konkretisht z. E.D, për konfliktin e ndodhur dhe për të saktësuar se është e padrejtë heqja e disa ditëve pune, pasi nuk ka patur asnjë shkak ligjor apo të ketë kryer ndonjë shkelje qoftë të lehtë apo të rëndë. Ju vëmë në dijeni se deri në këto momente, Albpetrol, nuk ka kthyer asnjë përgjigje zyrtare për ankimin e bërë nga ankuesi apo ndonjë njoftim në lidhje me këtë ankim. Ankuesi pretendon diskriminim për “çdo shkak tjetër”, duke pretenduar se trajtimi i padrejtë i ushtruar ndaj tij, ka ardhur edhe si shkak i ankesës së paraqitur pranë Drejtorisë së Shoqërisë Albpetrol. Edhe pas këtij konflikti, ditën e nesërme ankuesi është paraqitur në vendin e punës edhe pse ka qenë në gjendje të rënduar fizike dhe psikologjike, si pasojë e ngjarjes së ndodhur me datën 16.01.2024.

Ankuesi është paraqitur pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për të kërkuar leje ditore për datat 18, 19 dhe 22, janar 2024, por iu refuzua dhe iu komunikua që nuk mund të merrte leje pasi ndaj tij është hapur një proces gjyqësor. Gjithashtu theksojmë se ankuesit i është komunikuar në formë të prerë se me të, do të ndërpritet marrëdhënia e punës. Duke qenë se ankuesi ka qenë i aksidentuar si pasojë e aksidentit, ka qenë i detyruar për të kryer ekzaminime mjekësore dhe në këto kushte nuk ka mundur që të paraqitet në vendin e punës. Në bazë të ekzaminimit mjekësor të datës 19.01.2024, ankuesi provon se ka qenë duke kryer vizita mjekësore, në Qendrën Shëndetësore “Patos-Ruzhdie”. Nga ngjarja e mësipërme kuptohet se ankuesi nuk është paraqitur në punë për 3 ditë, për shkak të gjendjes së tij të rënduar shëndetësore.

Ankuesi pas konfliktit fizik ishte në gjendje të rënduar shëndetësore dhe në këto kushte në datën 20.01.2024 është paraqitur në Qendrën shëndetësore “Patos-Ruzhdie” për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore. Shoqëria Albpetrol, pa asnjë shkak ligjor ka marrë vendimin “Për dhënie mase disiplinore z. A.K, të datës 26.02.2024, në të cilin është vendosur:

- 1. Ti propozojë Administratorit të Shoqërisë Albpetrol, dhënien e masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”.*
- 2. Punonjësi, z. A.K: ka të drejtë për ankimin brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e këtij vendimi.*

Në datën 01.03.2024 Shoqëria “Albpetrol”, ka marrë Vendimin nr. 124 “Për përfundimin e marrëdhënieve të punës”, në të cilën është vendosur:

1. Përfundimin e marrëdhënieve të punës të z. A.K, me detyrë Murator-Karpienier, në Qendrën e Emergjencave dhe Mjedisit për Naftën dhe Gazin, Patos, të Shoqërisë Albpetrol, për shkak të shkeljes disiplinore, sipas vendimit të Komisionit Disiplinor të Shoqërisë.
2. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare të ndërpriten me datë 04.03.2024.

Së katërti, bazuar në faktet e mësipërme, ankuesi pretendon se shkak tjetër diskriminimi që i është kryer nga Punëdhënësi është marrja e masës disiplinore “Përfundimi i marrëdhënieve të punës”, pasi ankuesi në 45 vite punë, nuk ka marrë asnjëherë masë disiplinore qoftë në mënyrë verbale apo joverbale, çka nënkupton se nuk mund të merret një masë disiplinore e kësaj natyre dhe mosparaqitja në vendin e punës të konsiderohet si një shkelje e rëndë. Mosparaqitja në vendin e punës për 3 ditë dhe pa njoftuar punëdhënësin nuk përbën një shkelje të rëndë, siç pretendon punëdhënësi pasi ankuesi e ka vënë në dijeni Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, se si pasojë e aksidentit që ka pësuar, duhet të kryente ekzaminime mjekësore dhe duke qenë se nuk i kanë dhënë leje, duke e diskriminuar përsëri, ankuesi ka shkuar që të bëjë ekzaminimet mjekësore dhe në këto kushte nuk ka mundur të paraqitet në vendin e punës.

Sqarojmë se ndaj ankuesit ka ekzistuar një trajtim i diferencuar në raport me punëmarrësit e tjerë, si në kushtet e punës, mosdhënien e lejes në raste të gjendjes shëndetësore të rënduar, largimin nga puna pa respektuar procedurën dhe pa asnjë shkak ligjor”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga ana e Shoqërisë Albpetrol.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 800/2, datë 04.06.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti kundër të cilit është drejtuar ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
 - Kopje të dosjes personale të ankuesit (vendim emërimi, transferimi, kontrata pune, kopje të Librezës së Punës, vlerësim performance të tre viteve të fundit, etj).
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur nga ana e QEMNG Patos dhe Komisioni i Disiplinës së Albpetrol sh.a, lidhur me shqyrtimin e ngjarjes së datës 16.01.2024 dhe të largimit nga puna të ankuesit.
 - Kopje të ankesës së bërë nga z. A.K, pas ngjarjes së datës 16.01.2024 dhe përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol sh.a.
 - Arsytet se përse nuk i është dhënë leje ankuesit për datat 18, 19 dhe 22 janar 2024 dhe kopje të dokumentit ligjor në të cilën është parashikuar procedura e kërkesës dhe miratimit të lejes nga ana e Albpetrol sh.a.
 - Informacion të plotë, nëse ka pasur punonjës të tjerë (në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin), për të cilët është marrë masa disiplinore për largim nga puna. Nëse po, kopje të akteve.
 - Kopje të Statutit të Shoqërisë Albpetrol sh.a, të Strukturës Organizative, të Rregullores së Brendshme dhe Kontratës Kolektive të Punës nr. 1026, datë 10.02.2023.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe parashtrimeve të Albpetrol sh.a.

Me shkresën nr. 3337/1, datë 19.06.2024, Shoqëria Albpetrol sh.a, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Z. A.K ka qenë punonjës i Shoqërisë Albpetrol Sh.A, nga data 11.02.1986 deri me datë 04.03.2024, duke mbajtur pozicione të ndryshme pune. Në përfundim të marrëdhënieve të punës z. A.K ka mbajtur detyrën Murator/Karpentier pranë Qendrës së Emergjencave të Mjedisit të Naftës dhe Gazit, Patos në zbatim të strukturës organizative dhe organikës së miratuar me Vendimin Nr. 10, datë 04.10.2023 të Këshillit Mbikëqyrës si dhe strukturave të mëparshme.*

Zgjidhja e marrëdhënieve të punës me z. A.K nuk lidhet aspak me shkaqe diskriminuese si gjendja shëndetësore apo çdo shkak tjetër, por lidhet me veprime të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet e punës punëdhënës-punëmarrës, që në rastin konkret ankuesi ka kryer shkelje të rëndë disiplinore, si dhe nuk është paraqitur në vendin e punës.

Në vlerësimin e Shoqërisë Albpetrol sh.a, prezenca për t'u paraqitur në punë çdo ditë nuk është trajtim i diferencuar në raport me punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albpetrol sh.a. Paraqitja në punë dhe kryerja e punës çdo ditë është detyrim thelbësor i çdo punëmarrësi bazuar në kontratën e punës.

Bazuar në praktikën e ndjekur si dhe në Vendimin e Komisionit Disiplinor ndaj z. A.K është vlerësuar dhënia e masës disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës” parashikuar nga neni 156 i Kodit të Punës dhe nenet 48, pika 7, shkronja c/I, të Kontratës Kolektive të Punës.

Pra, është lehtësisht e vërtetueshme dhe e qartë, që ankuesi nuk ka respektuar kontratën e punës për të cilën është kontraktuar, duke mos njoftuar punëdhënësin për arsyet e mungesës së tij për datat 18, 19 dhe 22 Janar 2024, sikundër e ka pohuar edhe vetë në procesverbalin e takimit.

Në interpretim të rrethanave të çështjes, provohet se z. A.K ka kryer shkelje disiplinore të rëndë dhe nuk është paraqitur në vendin e punës për 3 ditë rresht pa arsye duke mos depozituar asnjë shkak të justifikuar për mungesat e tij.

Të gjitha shkaqet e mësipërme provojnë se ankuesi nuk është diskriminuar për shkak të gjendjes shëndetësore apo çdo shkak tjetër, dhe në vlerësimin tonë pretendimi është tërësisht i pabazuar dhe mungon lidhja shkakësore midis këtij pretendimi dhe ankesës së punonjësit.

Me qëllim sqarimin sa më të drejtë të çështjes objekt gjykimi pranë institucionit tuaj, ju vendosim në dispozicion edhe raste të tjerë të punëmarrësve të cilët kanë kryer shkelje të rëndë disiplinore dhe ndaj tyre është marrë masa “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës” (rasti i ish-punëmarrësit z. E.F).

Gjithashtu ju informojmë se në vitin 2023 Shoqëria Albpetrol sh.a, ka miratuar Strukturat dhe Organikat e Shoqërisë Albpetrol sh.a, sipas legjislacionit në fuqi dhe se këto ndryshime në emërtesa të pozicioneve të punës kanë ardhur si nevojë e domosdoshme e përshtatjes së organikave pranë Shoqërisë Albpetrol SH.A, konform përcaktimeve ligjore me qëllim përfitimin e statusit të naftëtarit të punonjësve të cilët punojnë në sistemin e naftës.

Gjithashtu edhe në strukturat e mëparshme organizative pozicioni i punës në të cilin ka punuar z. A.K ka pasur të njëjtën emërtesë Murator-karpentier.

Përsa pretendohet nga z. A.K se Shoqëria Albpetrol sh.a, ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme diskriminuese përgjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës si pasojë e aksidentit në punë, sqarojmë se z. A.K si pasojë e aksidentit të ndodhur ka përfutur dëmshpërblim ekonomik nga punëdhënësi Albpetrol sh.a, mbështetur në Kontratën Kolektive të Punës nr. 10645, datë 22.11.2019.

Gjithashtu lidhur me pretendimin se pse z. A.K nuk i është akorduar leja, ju bëjmë me dije se: Kërkesa për leje është bërë në kundërshtim me nenin 93, pika 1 të Kodit të Punës, si dhe Rregullores së Brendshme të Shoqërisë”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 24.06.2024, është njohur me përgjigjen e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 800/4, datë 15.07.2024, përfaqësuesi i ankuesit ka nisur kundërshtimet e tij kundrejt informacionit të dërguar nga Shoqëria Albpetrol, duke informuar si vijon: “1. Shoqëria Albpetrol sh.a, pretendon se ndryshimet në emërtesat e pozicioneve të punës kanë ardhur si nevojë e domosdoshme e përshtatjes së organikave të Shoqërisë.

Në lidhje me këtë pretendim, ankuesi gjatë marrëdhënies së punës ka mbajtur vetëm detyrën “Murator” pranë Qendrës së Emergjencave të Mjedisit të Naftës dhe të Gazit, Patos, vërtetuar me Librezën e Punës të lëshuar nga Shoqëria Albpetrol sh.a, që të ushtrojë vetëm pozicionin “Murator”. Veprimet e kryera nga ana e Shoqërisë për ndryshimet e kryera për emërtesat e pozicioneve të punës janë bërë për interesin e tyre dhe pa e vënë në dijeni Punëmarrësin A.K. Përpos faktit se edhe në konfliktin që ka patur në datën 16.01.2024, për emërtimin “Murator-Karpiertier”, ankuesin nuk e kanë vënë në dijeni për këto ndryshime në emërtesat e pozicioneve të punës.

Gjithashtu ju vëmë në dijeni se ankuesi nuk është i specializuar për të ushtruar pozicione të tjera pune, ku këta të fundit siç jeni edhe Ju në dijeni i cenuan jetën në aksidentin e datës 21.02.2022, të ndodhur në punë. Nga ana e Shoqërisë nuk është bërë asnjë përpjekje për të kryer trajnime të ndryshme për Punëmarrësin dhe më pas kur të jetë i aftë për të kryer një pozicion pune jashtë kategorisë së profesionit të tij dhe në konform me ligjin ti ngarkohen këto kategori pune.

2. Nga ana e Shoqërisë pretendohet se ankuesi e ka bërë kërkesën për marrjen e lejes në kundërshtim me nenin 93, pika 1 të Kodit të Punës.

Shoqëria Albpetrol sh.a nuk ka asnjë provë të pretendojë se nuk është vënë në dijeni nga ankuesi, pasi në praktikën e mbajtur prej saj interpreton qartë se ka qenë në dijeni se ankuesi do të mungonte, pasi pohon se ankuesi nuk ka respektuar rregullat për marrjen e lejes.

Gjithashtu ankuesi e ka njoftuar Punëdhënësin për arsyet e mungesës së tij për datat 18, 19, 22 janar 2024. Sqarojmë se në datën 18.01.2024, ankuesit i është caktuar data e vizitës për t’u ekzaminuar nga mjeku ligjor për hetimin që ka nisur Prokuroria Fier (provuar me ekzaminimin e datës 18.01.2024, pranë Mjekut-ligjor Dr. B.P dhe Vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Fier).

3. Shoqëria pretendon se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument për të justifikuar mungesat e tij për datat 18, 19, 22 Janar 2024, por bazuar nga provat shkresore rezulton e kundërta.

Po ashtu pretendimi i mësipërm është i pavërtetë, pasi siç e kemi parashtruar edhe në ankim, dokumentet shkresore në formën e kërkuar nga ligji kanë fuqi ligjore provuese dhe në rastin konkret këto prova justifikojnë mungesat. Në këto kushte sqarojmë edhe njëherë se punëdhënësi ka qenë në dijeni se ankuesi nuk do të paraqitej në punë në datat e sipërcituara.

4. Fakti që Shoqëria i ka dhënë dëmshtëpërblim ekonomik ankuesit për aksidentin e ndodhur në punë, nuk e përjashton faktin që edhe pse i ka ofruar këtë ndihmë ekonomike të mos ketë kryer veprime të tjera që sjellin pasojën, diskriminimin e ankuesit në marrëdhënien e punës”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 800/5, datë 15.08.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 28.08.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 28.08.2024, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, i përfaqësuar me Prokurën e Posaçme nr. repertori 3166, nr. koleksioni 1148, datë 19.04.2024, nga Av. E.J dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses së Shoqërisë Albpetrol, me autorizim nr. 5043, datë 26.08.2024, znj. E.Ç.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Me shkresën nr. 5645, datë 01.10.2024, Shoqëria Albpetrol sh.a, dërgoi dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore.

1. Në vijim të kërkesave të Komisionerit, Shoqëria Albpetrol sh.a, gjatë seancës dëgjimore depozitoi pranë KMD-së kopje të dokumentacionit të kërkuar.

Pjesë e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, është dhe Kërkesë - Padia drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me paditës: subjektin ankues: A.K dhe subjekt të paditur: Shoqëria Albpetrol sh.a.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se, në objekt të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhënien e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhen prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në objekt të kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi, pranë Gjykatës, ndër të tjera, kërkohet:

“6. Detyrimin e palës së Paditur të dëmshtëpërblejë Paditësin për diskriminimin që ka kryer i Padituri në marrëdhënien e punës”.

Në bazën ligjore ankuesi në mes të tjerash i është referuar dhe nenit 34, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në parashtrimet e tij në kërkesë padi, ankuesi në mes të tjerash ka cituar shprehimisht se: “...Së pesti, duke qenë se i Padituri ka ndërprerë marrëdhënien e punës pa asnjë shkak ligjor, ka detyrimin që të dëmshpërblejë Paditësin për diskriminim që ka kryer ndaj tij në marrëdhënien e punës”.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka kërkuar *inter alia*, dhe dëmshpërblim për diskriminim nga ana e punëdhënësit/Shoqëria Albpetrol sh.a, lidhur me largimin e tij nga puna, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 115, datë 27.05.2024, të z. A.K, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj³.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁴, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

³ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, datë 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, të Komisionerit.

⁴ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 115, datë 27.05.2024, të paraqitur nga subjekti ankues, A.K kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA